

**UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”**

**FAKULTETI JURIDIK**



**PLANI STRATEGJIK I FAKULTETIT JURIDIK**

**2019-2021**

**MARS, 2019**

## Hyrje

Plani Strategjik për Fakultetin Juridik 2019-2021 është dokument i cili paraqet orientimin e politikave zhvillimore akademike për periudhën e ardhshme tre vjeçare. Ky plan është hartuar në përputhje me Strategjinë në kuadër të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini” duke i’u përshtatur misionit, vizionit, orientimit, dhe objektivave të universitetit. Si program specifik, Fakulteti Juridik është kujdesur që përmes këtij plani të paraqes objektivat e tij kyçe për zhvillim në vitet në vazhdim.

Fakulteti Juridik i Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini” vazhdon të mbetet i përkushtuar në përmbushjen e objektivave afatgjata të investimit në gjeneratën e re të juristëve, investim nga i cili, përveç vetë studentëve, do të përfitojnë të gjithë ata të cilëve do u shërbejnë këtë të fundit. Nëpërmjet programit të vet, Fakulteti Juridik mëton që të vazhdoj të kontribuoj në plotësimin e hartës së juristëve profesionistë, të gatshëm për t’u përballur me kërkesat e tregut të punës, dhe për t’iu përgjigjur në mënyrë adekuate kërkesave të komunitetit dhe nevojave të përgjithshme të shoqërisë kosovare.

Ky plan, është shkruar duke konsideruar një numër të madh faktorësh të cilët kanë ndikuar në formën e tij finale. Ndër këta faktor, rol kyç në përpilimin e këtij dokumenti kanë luajtur analiza e thukët e programeve që ofrohen në të gjitha universitetet në Kosovë e rajon, analizat profesionale të stafit akademik aktualisht të punësuar në Universitetin e Mitrovicës, konsultimet me studentë dhe komunitetin e juristëve, si dhe të dhëna nga kërkesat e tregut të punës e hulumtuar nga personat e angazhuar në përpilimin e kësaj strategjie.

Strategjia është e përpiluar në atë formë që të ofroj të dhëna për profilin e Fakultetit Juridik, duke përfshirë misionin dhe vizionin mbi të cilin funksionon ky program studimesh. E gjithë strategjia mbështetet në tri shtylla kryesore zhvillimi: zhvillimi i rregullt i procesit mësimor; planifikimi për studentët e rinjë; planifikimi për hulumtim dhe organizime brenda fakultetit; sigurimi i cilësisë dhe avansimi i vet stafit akademik tashmë të punësuar apo ata që mëtojnë të punësohen në këtë program.

## **1. Profili i Fakultetit Juridik**

Duke u nisur nga nevoja e domosdoshme për organizimin dhe zhvillimin e arsimit të lartë sipas standardeve dhe kriterëve të universiteteve evropiane dhe më gjerë, Fakulteti Juridik në kuadër të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, ka dizajnuar modelin e studimeve të reformuara sipas planeve dhe programeve të mbështetura në rekomandimet e Deklaratës së Bolonjës.

Fakulteti Juridik ka për qëllim që të tërheq studentë të jashtëzakonshëm të cilët janë të gatshëm që t’i dedikojnë të gjitha përpjekjet e tyre ndaj një programi sfidues, të cilët janë të gatshëm të marrin përgjegjësi si gjyqëtar, prokurorë, avokatë dhe profesionist tjerë ligjor në të ardhmen. Fakulteti Juridik funksionon në hapësirën e kampusit qendror në Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini”.

Studimet në këtë program janë të organizuara në një drejtim (Juridik i Përgjithshëm) për 7 (shtatë) semestra, kurse në semestrin e 8 (tetë) duke i lejuar studentët të profilizohen në ndonjërin prej këtyre moduleve:

- E drejta Publike;
- E drejta Private.

### **1.1.Themelimi**

Fakulteti Juridik i Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini” është themeluar më 04.07.2014, me vendimin nr.548/14, datë 04.07.2014, i lëshuar nga Këshilli Shtetëror për Cilësi (KSHC) i Agjencionit të Kosovës për Akreditim, respektivisht me vendimin që përmirëson vendimin paraprak nr 165115, datë 17.03.2015.

### **1.2.Procesi i akreditimit**

Fakulteti Juridik, është akredituar me vendimin nr. 548/14, datë 04.07.2014, i lëshuar nga Këshilli Shtetëror për Cilësi (KSHC) i Agjencionit të Kosovës për Akreditim. Fakulteti Juridik është ri-akredituar me Vendimin nr. 535/2017, datë 06.07.2017 nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë, për periudhën 3 vjeçare.

Ndërkohë, me Vendimin nr. 465/18D, të datës 18.05.2018 e Këshillit Shtetëror për Cilësi (KSHC) të Agjencionit të Kosovës për Akreditim, është zgatur periudha e akreditimit edhe për 1 (një) vit, pra deri me 30 (tridhjetë) shtator 2021.

Fakulteti Juridik, synon që deri më 2021 të aplikoj në AKA me kërkesën për të akredituar një program të masterit në varësi nga kërkesat të cilat do të identifikohen nga një grup i veçantë punues për të iu përgjigjur nevojave të tregut.

### **1.3.Historik i shkurtër i aktiviteteve të Fakultetit Juridik**

Në një kohë të shkurtër të funksionimit, në Fakultetin Juridik janë organizuar ngjarje të rëndësishme të cilat kanë përfshirë studentët dhe stafin akademik. Të tilla janë:

- Pjesëmarrja e studentëve në garën e Harvard Model United Nations në Universitetin e Harvardit në ShBA, si ngjarja më e sofistikuar e këtij lloji e cila mbledhë studentët nga universitetet e gjithë botës në simulimin e punës së organeve të OKB-së. Kjo ngjarje është financuar nga MASHT dhe USAID në shkurt të vitit 2017.
- Nga tetori 2017 deri në qershor 2018, në kuadër të Klinikës Juridike Penale janë mbajtur çdo javë ligjërata dhe diskutime me gjyqtar, prokuror dhe avokatë. Klinika Juridike Penale është projekt që realizohet falë Marrëveshjes së Mirëkuptimit ndërmjet Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, përkatësisht Fakultetit Juridik, National Center for State Courts (NCSC) dhe Odës së Avokatëve të Kosovës.
- Çdo vit radhazi, një grup i studentëve të Fakultetit Juridik realizon vizita në institucionet relevante të Republikës së Kosovës për t’u njohur më afër me punën e tyre. Vizita të tilla përfshijnë institucione si Avokati i Popullit, Gjykata Kushtetuese, Agjencia e Kosovës për Forenzikë dhe institucione të tjera. Vizita të tilla realizohen me qëllim të njoftimit nga afër mbi problemet konkrete që ka Kosova në fushën e të drejtave të njeriut; rolin dhe punën e këtyre institucioneve në Kosovë; shumë aspekte të vendimmarrjes së gjykatave; veprimtarisë hetuese të prokurorëve dhe policëve, dhe të ngjashme me këto.
- Në muajin qershor 2018, në garën për gjykim të simuluar organizuar nga National Center for State Courts (NCSC), në të cilën morën pjesë studentët nga 5 universitete publike në Kosovë, studentët e Fakultetit Juridik të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini” kanë zënë vendin e parë. Ky rezultat ishte arritur falë angazhimit dhe

përkushtimit shumë të madh që studentët kishin treguar gjatë gjithë semestrit veror në kuadër të projektit “Klinika Juridike Penale”.

- Studentët poashtu kanë organizuar debate brenda Fakultetit, me fokus në liritë dhe ë drejtat e njeriut: sfidat dhe perspektivat; të drejtat pronësore dhe çështjet gjinore që lidhen me to si dhe debate të tjera që kanë adresuar çështje me rëndësi. Debate të tilla në vazhdimësi janë mbështetur nga stafi akademik, po ashtu edhe nga organizata vendore dhe ndërkombëtare.
- Në muajin dhjetor 2018, Fakulteti Juridik ka marrë pëlqimin për pjesëmarrjen e studentëve të Fakultetit Juridik në seancat gjyqësore, nga fusha civile dhe penale në Gjykatën Themelore në Mitrovicë.

## **2. Misioni dhe Vizioni**

Fakulteti Juridik i Universitetit të Mitrovicës është i dedikuar që të mirëpres studentët dhe t'i pajisë ata me njohuri të sofistikuar për t'i përgatitur që të bëhen juristë profesionistë që janë të gatshëm të marrin përsipër përgjegjësitë e gjykatësve, prokurorëve, avokatëve apo punonjësve të tjerë të çështjeve juridike. Përveç njohurive profesionale, studentët e këtij programi trajnohen në një ambient dinamik që themelet i ka në një etikë të lartë të punës dhe bashkëpunimit. Misioni kryesor i Fakultetit Juridik është që të ofroj një përvojë të veçantë studiuëse e cila gërsheton brenda vetes vlerat fundamentale të sistemit të drejtësisë dhe i transformon ato nga dija në punë praktike.

Vizioni i Fakultetit Juridik të Universitetit të Mitrovicës është që të shndërrohet në një qendër gravituese për studiuesit e së drejtës në Kosovë, që synim kryesorë ka avansimin e dijes juridike tek të rinjtë kosovarë. Bashkëdyjëzimi i përpjekjeve dhe investimeve të studentëve dhe stafit administrativ e akademik konsiderohet të jetë suksesi i këtij programi. Duke gëzuar përkushtimin e jashtëzakonshëm të të gjithë personelit universitar, Fakulteti Juridik ofron një mundësi unike të zhvillimit të profesionit për një numër të konsiderueshëm studentësh të cilët edukohen që të ushtrojnë profesionin në ambiente dinamike që i përgjigjen kërkesave të kohës.

Ky fakultet, synon të ketë rol të rëndësishëm në zhvillimin e arsimit lidhur me reformimin ligjor, aftësimin shkencor, aftësimin e kuadrove për praktikën gjyqësore, për aktivitete akademike dhe për administratën shtetërore. I tërë aktiviteti mësimor dhe kërkimor shkencor

mbështetet në standarde të larta të procesit të mësimdhënies, mësim-nxënies dhe vlerësimit të njohurive të studentëve, pa lënë pas dore edhe kërkimet shkencore. Fakulteti Juridik ka për synim të krijoj, të zhvilloj dhe të transmetoj njohuri në shumë disiplina të së drejtës përmes mësimdhënies, punës praktike – klinikave ligjore dhe punës kërkimore shkencore, po ashtu të ofroj mundësi për të gjithë qytetarët e Kosovës që dëshirojnë të përfitojnë nga ky arsim gjatë gjithë jetës së tyre.

### **3. Synimi i programit të Fakultetit Juridik**

Fakulteti Juridik me programin e vet synon që në një periudhë të shkurtër kohore të përmbushë këto qëllime:

- Të vazhdoj të atraktojë studentë të profilit të lartë që kanë për qëllim zhvillimin e dijes në fushën juridike;
- Të ruaj dhe avansojë tutje pozitën e njërës përj programeve më kualitative të fushës juridike në Kosovë;
- Të edukojë dhe pajisë me njohuri të sofistikuara juridike studentët që përgatiten të ushtrojnë profesionin e juristit;
- Të shkathtësoj studiuesit e së drejtës me aftësi kritikuese, analitike dhe kërkuese që janë kërkesë e domosdoshme në ushtrimin e profesionit pas diplomimit

### **4. Rezultatet e pritura të programit**

Pas mbarimit të programit të studimit juristi i diplomuar do të jetë i përgatitur me njohuri kualitative arsimore – profesionale dhe shkencore në shumë fusha të drejtësisë, me qëllim që në jetën juridike dhe gjyqësore t'i përballoj sfidat që do t'u paraqiten. Përmes programit të ofruar, Fakulteti Juridik është i përkushtuar për sigurimin e kualitetit të lartë të mësimdhënies, mësimnxënies, vlerësimit të njohurive të studentëve dhe përmirësimin e kushteve brenda kapaciteteve ekzistuese për të ofruar arsimim cilësor, kualitativ dhe efektiv.

### **5. Ndërkombëtarizimi**

Programi i Fakultetit Juridik në Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini” është i krahasueshëm dhe i ngjashëm me programet e universiteteve në rajon si Fakulteti Juridik nga Universiteti i Ljubljanes, Fakulteti Juridik i Universitetit të Zagrebit, Fakulteti Juridik

i Universitetit të Sarajevës, si dhe universitetet nga Bashkimi Evropian si Universiteti i Mastritit dhe, Freie Universitat -Berlin.

Qëllimi final i programit është që të bëhet konkurrent real në tregun e punës, duke marrë për bazë aspektin e globalizimit dhe nevojës së qarkullimit të punëtorëve dhe pse jo edhe të vetë studentëve, gjatë periudhës së studimeve.

Përafrimi i programit me programe të tjera të studimit, por gjithmonë duke e ruajtur veçantinë dhe origjinalitetin e mësimdhënies dhe organizimit të kurrikulës, ka për synim ngritjen e nivelit të bashkëpunimit ndër-universitar, dhe ofrimin të mundësive më të lehta për shkëmbim të studentëve dhe praktikave ndër-institucionale.

## **6. Plani i hulumtimeve**

Në kuadër të Fakultetit Juridik realizohen hulumtime dhe studime të planifikuara për të cilat vendoset duke iu përshtatur kërkesave të kohës dhe trendit të zhvillimeve në fushën juridike brenda Kosovës dhe jashtë saj. Përpilimi i planit të hulumtimeve bëhet duke konsideruar opinionin dhe kontributin e secilit pjesëtar të stafit akademik të programit. Duke u mbështetur në këto parime të përpilimit të planit, Fakulteti Juridik në këtë periudhë të zhvillimit të vet, ka planifikuar që të realizoj hulumtime në këto fusha me interes:

- Legjislacioni i Kosovës dhe integrimi evropian;
- Rregullimi ligjor dhe funksionimi praktik i profesioneve të lira ligjore;
- Një analizë mbi politikat gjyqësore në Kosovë;
- Një analizë mbi mekanizmat ligjor dhe institucional të luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit;
- Një analizë mbi reformën në administratën publike;
- Një analizë mbi reformën në sistemin zgjedhor.

## **7. Rekrutimi i stafit akademik**

Në Fakultetin Juridik në marrëdhënie të rregullt dhe të angazhuar të punës janë këta profesorë dhe asistentë:

Stafi Akademik në marrëdhënie të rregullt pune:

Profesorë asistentë:

- Prof.Ass.Dr. Agron Beka
- Prof.Ass.Dr. Islam Qerimi
- Prof.Ass.Dr. Halil Bajrami
- Prof.Ass.Dr. Arta Dauti

Asistentë:

- Ass.LL.M. Zahir Çerkini, PhD.Cand.
- Ass.LL.M. Xhemjal Veliqi, PhD.Cand.
- Ass.LL.M. Përparim Gruda, PhD.Cand.
- Ass.LL.M. Doruntinë Demiri.
- Ass.LL.M. Mimoza Aliu, PhD.Cand.
- Ass.LL.M. Kushtrim Palushi.

Stafi akademik me angazhim:

- Prof.Dr. Enver Hasani;
- Prof.Dr. Beqir Sadikaj;
- Prof.Asoc.Rrustem Qehaja;
- Prof.Ass.Dr. Xhevdet Halili;
- Ass.LL.M. Bashkim Preteni, PhD.Cand.

Në përmbushje të rekomandimeve të EE-së së AKA-së, Fakulteti Juridik, deri në fund të vitit 2020 parasheh të arrij edhe minimum 5 profesorë me gradën Dr.Sc, prej të cilëve shumica do të jenë asistent që janë në përfundim të studimeve të tyre të doktoraturës. Fakulteti Juridik do të angazhohet që të shpejtoj procedurat për avansimin e stafit akademik. Poashtu, jashtë avansimit të stafit aktual, rekrutimi do të përfshijë edhe profesorë dhe asistent të rinjë.

## **8. Studentët**

Fakulteti Juridik pranimin e studentëve të rinjë e bën përmes një konkursi publik. Gjithsejt në Fakultetin Juridik pranohen 160 studentë. Secili kandidat që e kalon testin e maturës dhe



plotëson kushtet tjera, gëzon të drejtën për të konkurruar për studime në Fakultetin Juridik sipas legjisllacionit në fuqi.

Studentët në Fakultetin Juridik mbahen të angazhuar në procesin e studimeve përmes ligjeratave, ushtrimeve, hulumtimit dhe punës praktike. Duke e konsideruar rëndësinë e aplikimit të njohurive teorike në punë praktike, programi i Fakultetit Juridik është dizajnuar që të ketë 70% qasje teorike dhe 30% qasje praktike. Qëllimi kryesor i programit në këtë proporcion është që të sigurohet se secili student do vjelë avantazhet e mentorimit praktik në klinikat juridike që ofrohen brenda dhe jashtë universitetit, nëpërmjet bashkëpunimit ndër-institucional me gjykata, zyra avokatie, apo institucione të tjera publike të vendit.

Në Fakultetin Juridik, nuk ka asnjë qëllim më të madh sesa vendosja e interesit të studentit në majën e objektivave. Prandaj, si program, i tërë kapaciteti akademik dhe administrativ është i përqëndruar në ofrimin e mundësive për zhvillimin profesional dhe etik të këtyre juristëve të së ardhmes. Ky synim arrihet duke kërkuar nga secili student bashkëpunim dhe partneritet të vahdushëm me secilin pjesëtar të stafit; duke u siguruar që secili pjesëtar i stafit ofron shërbimet e kërkuara dhe është bashkëpunues me secilin student, si dhe duke ofruar mundësi bashkëpunimi për studentët dhe institucionet relevante që përbëjnë interes të veçantë në zhvillimin e tyre akademik;

## **9. Strategjia për zhvillim në disa fusha specifike për tre vitet e ardhshme**

Plan i punës i Fakultetit Juridik, për tre vitet e ardhshme përmban objektivat kryesore dhe aktivitetet që planifikohet të kryhen për të përmbushur këto objektiva.

### **I. Realizimi i procesit mësimor sipas planit të parashikuar**

Pasi të diskutohet me të gjithë anëtarët e stafit akademik për rrjedhën e procesin mësimor, për të arriturat dhe sfidat, do të bëhen planifikimet e duhura dhe do të merren të gjitha masat që realizimi i mësimit të kryhet pa asnjë pengesë në vitet vijuese, duke realizuar në tërësi parashikimet dhe rezultatet e pritura të përcaktuara në syllabus për secilën lëndë.

Fakulteti do të marr të gjitha masat për orët që do të humben me rastin e festave të kompensohen në tërësi në mënyrë që studentët të mos humbin asnjë orë mësimore.

Në pjesën e provimeve, do të ketë një diskutim të hollësishëm për mënyrën e mbajtjes së tyre, nëse duhet mbajtur me shkrim apo me gojë. Kjo vendimmarrje do të udhëhiqet nga qasje që të i shërbej sa më shumë ngritjes së cilësisë së mësimi dhe të nxëniti tek studentët.

## **II. Implementimi i rekomandimeve të ekspertëve të akreditimit**

Në përgjigje të ekipit të ekspertëve të akreditimit, Fakulteti do të marrë këto hapa:

Sipas rekomandimit të EE-së, dhe, sipas planit për zgjerimin e stafit, Fakulteti Juridik do të ketë deri me 2020, 5 (pesë) doktor të shkencave në lemitë përkatëse. Gjatë këtyre viteve organet akademike të Universitetit do të kujdesen që me kohë të hapin konkursin e ri për profesor duke definuar qartë kriteret dhe standardet për zgjedhjen e personelit akademik.

Universiteti i Mitrovicës në vitet vijuese, do të realizoj disa marrëveshje me universitete tjera të cilat do t'i mundësojnë stafit akademik dhe studentëve të ndjekin studime për një periudhë të caktuar jashtë vendit, në vazhden e plotësimit të rekomandimeve të EE-së. Në kuadër të kësaj, stafi akademik i Fakultetit Juridik do të jetë pjesë e disa programeve të tilla. Poashtu, do të realizohen marrëveshje me institucione tjera kombëtare dhe ndërkombëtare të cilat do mundësojnë lehtësimin e punës kërkimore shkencore për profesorët dhe studentët.

Gjithashtu, do përmbushet rekomandimi tjetër i EE-së që Fakulteti në bashkëpunim me universitetin të ofroj hapësira rekreative për studentët.

## **III. Realizimi i aktiviteteve jashtë-kurrikulare**

1. Vazhdimi i punës dhe publikimi i revistës shkencore bordi editorial i të cilës është në përbërje të stafit akademik dhe studentëve më të mirë të fakultetit;
2. Realizimi i trajnimeve, vizitave studimore, konferencave Organizimi i klinikave juridike në bashkëpunim me institucionet relevante dhe organizatat e huaja dhe ato të shoqërisë civile që operojnë në Kosovë.

#### **IV. Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione të ndryshme të zbatimit të ligjit**

Me qëllim që studentëve të ju mundësohet realizimi i punës praktike, zhvillimi i shkathtësive të nevojshme për tregun e punës, Fakulteti Juridik do të nënshkruaj një sëri memorandumesh të mirëkuptimit me: Gjykatat, prokuroritë, odën e avokateve, oden e noterëve dhe institucione të tjera të zbatimit të ligjit.

#### **V. Krijimi i sistemit ALUMNI**

Fakulteti do të krijoj një bazë të të dhënave për të përcjellur të arriturat e studentëve që diplomojnë. Kjo bazë e të dhënave do të freskohet me to në çdo afat të rregullt të diplomimit. Të dhënat e studentëve të Fakultetit Juridik do të transferohen në të dhënat në databazën ALUMNI në nivel qëndror.

### **10. Sigurimi i cilësisë**

Synimi i zhvillimit të sistemit të sigurimit të cilësisë në Fakultetin Juridik përfshinë hartimin e politikave, procedurave, kulturës për sigurimin e cilësisë, duke e krahasuar me standardet në nivel të UMIB. Në Fakultetin Juridik, synim i veçantë në sigurimin e cilësisë është sistemi i vetëvlerësimit, mbikqyrjes dhe akreditimit, dhe e gjitha kjo duke respektuar autonominë. Sistemi i sigurimit të cilësisë dhe vlerësimi periodik fokusohen në:

- Menaxhim;
- Organizim
- Politikat e qëndrueshme për rekrutimin e stafit;
- Procesin e mësim;
- Rritjen e mobiliteteve të pedagogëve dhe studentëve;
- Prezantimin dhe zbatimin e ECTS, skemën e akreditimit, zhvillimit të kurrikulës, metodat e reja të mësim-nxënjes dhe mentorimit
- Procesin e kërkimit dhe hulumtimit shkencor.

## **11. Përfundim**

Plani Strategjik i Fakultetit Juridik të Universitetit të Mitrovicës, përmbanë pikat dhe objektivat minimale të vendosura për të garantuar qëndrueshmëri të programit dhe një zhvillim më të madh akademik. Strategjia përfshinë orientimin drejtë përforcimit të standardeve aktuale mbi të cilat funksionon program i Fakultetit Juridik dhe avansimin tutje të këtyre standardeve. Vendosja e studentit në qendër dhe ofrimi i mundësive sa më të mëdha për ta paraqet tjetër parim mbi të cilin do të funksionoj kjo strategji. Fakulteti Juridik, do të kujdeset që të përmbushë në përpikmëri strategjinë me qëllim të ofrimit të një programi sa më të kompletuar për studentët dhe mbetjes konkurent të denjë me institucionet tjera që ofrojnë edukim juridik.